



© O.Nika / PPNEA: Kanioni i Lengaricës

Pse Vjosa duhet të jetë Park Kombëtar?


Lumi Vjosa është një nga lumenjtë e fundit natyrorë të Evropës. Për 270 kilometra ai rrjedh pa ndërprerje me kanione, shpella, ujëvara, livadhe, pyje, burime dhe ishuj të vegjël. Biodiversiteti dhe bukuritë e peizazhit janë arsye që Vjosa duhet të jetë një Zonë e Mbrojtur.



© L.Kirgeçit: Arbutus andrachne



© Jack Perks/Alamy
Anguilla anguilla



© Vladimir Motyčka: Motyčka
Lutra lutra

Nga ana tjetër shumica e njerëzve në Shqipëri nuk janë të informuar që Vjosa është një lumë unik në të gjithë kontinentin evropian, një thesar natyror evropian. Ky Park Kombëtar i propozuar, nuk ekziston aktualisht jo vetëm në Evropë por ndoshta edhe në mbarë botën. Shpallja e një Parku Kombëtar në Vjosë, do të mbronte jo vetëm vlerat e biodiversitetit dhe proceset ekologjike të këtij ekosistemi, por edhe ekonominë lokale: Në të ardhmen mijëra turistë nga e gjithë Evropa do të vijnë për ta vizituar këtë lumë të egër, si dhe për të zhvilluar aktivitete të turizmit ekologjik si hiking, rafting, dhe peshkim sportiv. Ne kemi sot detyrimin moral për të mbrojtur këtë trashëgimi natyrore për veten, brezat e ardhshëm dhe për vetë natyrën.



© R.Durst: Rrjedha e sipërme e Vjosës



© F.Bego: Flamingo në deltën e Vjosës

Lumenjtë e Ballkanit- Hotspoti i biodiversitetit

Më shumë se 60% e të gjithë lumenjve në rajon janë në gjendje të mirë ose shumë të mirë hidromorfologjike.

Rreth 69 lloje peshqish janë endemike dhe më shumë se 50% e të gjitha llojeve të molusqeve të ujërave të ëmbla në Evropë, janë të përhapura në lumenjtë e Ballkanit.



© Johnny Jensen: Trofta

Megjithatë, kjo "Zemër Blu e Evropës" kërcënohet nga ndërtimi i më shumë se 570 digave për qëllime hidroenergjetike (> 1 MW), që janë projektuar që nga Sllovenia deri në Shqipëri.

Për këtë arsye, OJQ-të ndërkombëtare Riverwatch dhe Euronatur në bashkëpunim me disa organizata lokale partnere si PPNEA në Shqipëri, kanë nisur fushatën "Të Shpëtojme Zemrën Blu Të Evropës" me qëllim mbrojtjen e lumenjve me potenciale të mëdha natyrore që shtrihen në Evropën Juglindore, nga shkatërrimi përmes zhvillimit të pakontrolluar të projekteve të hidroenergjisë.



© Goran Safarek

Më tepër infomacion:
<http://balkanrivers.net/>
Kontakt:
info@balkanrivers.net

Ky projekt financohet nga:



Ky projekt zbatohet në Shqipëri nga:



Vjosa Park Kombëtar




© R.Durst:Rrjedha e mesme e Vjosës

Lumi Vjosa


Lumi Vjosa është një nga lumenjtë e fundit, "të egër" të Evropës. Në rrugën e saj mbi 270 km, Vjosa rrjedh e pandikuar në mënyrë të natyrshe, e karakterizuar nga kanione të bukur, rrjedha të rrëmbyeshme, ishuj dhe kthesa që krijojnë gjarpërime të mrekullueshme. Në disa zona shtrati i lumit arrin një gjerësi më shumë se 2 km. Së bashku me degët e saj, Vjosa ofron një ekosistem dinamik, pothuajse natyror. Ky ekosistem unik në kontinent, edhe pse i panjohur, përfaqëson një trashëgimi të vërtetë natyrore Evropiane. Në 80 km e para të rrjedhës së tij, përmes Greqisë lumi quhet Aoós, ndërsa me hyrjen në territorin shqiptar ai ndryshon emrin në Vjosë. Gjarpërimet e rrjedhës së poshtëme krijojnë një luginë të gjerë me habitate ligatinore, që bëhen strehë për peshqit, shpendët migratorë dhe shumë specie të tjera. Rrugëtimi i saj natyror përfundon në detin Adri-atik, në veri të lagunës së Nartës - një nga lagunat më të mëdha dhe ekologjikisht më të pasura në bregdetin shqiptar, e përcaktuar si Rezervat Natyror i Menaxhuar. Vjosa zë një sipërfaqe totale prej 6,700 km² në Shqipëri dhe Greqi së bashku dhe shkarkon në detin Adriatik një mesatare uji prej 204 m³/s.

Skema e shfrytëzimit të Lumit Vjosa



Park Kombëtar apo HEC?

Nevoja për energji është thelbësore për zhvillimin, por duhen analizuar me kujdes mënyrat e prodhimit të saj. Hidroenergji është një nga format e energjisë së rinovueshme, por përvojat e huaja kanë dëshmuar tashmë se digat shkatërrojnë në mënyrë të pakthyeshme ekosistemet natyrore. Kjo bëhet edhe më e qartë nëse i referohemi gjendjes së lumenjve në Evropën Qendrore, të cilët paraqiten thellësisht të tjetërsuar. Vlen të theksohet se është pikërisht kjo gjendje natyrore e lumenjve tanë, një vlerë e shtuar, e cila nëpërmjet një përdorimi të kujdesshëm, mund të përkthehet lehtësisht në përfitime konkrete ekonomike. Një hidrocentral i vetëm mund të prodhojë të ardhura të krahasueshme me ato që mund të sigurohen nga përdorime alternative të shërbimeve të të njëjtit ekosistem, por çështja është se cila pjesë e këtyre të ardhurave shkon drejtpërdrejt në përfitim të komunitetit lokal. Janë të shumtë shembujt që shpjegojnë se vendet shumë të pasura, janë në fakt vendet më të varfëra. Nga ana tjetër shumë shembuj nga bota, tregojnë se përfitimet e ekonomisë vendore nga krijimi i parqeve kombëtare janë më të larta sesa nga projektet e mëdha industriale. Në përfundim është e rëndësishme të thuhet se ndërtimi i digave shkatërron përfundimisht mundësinë e alternativave të tjera të përdorimit të këtij ekosistemi unik në të ardhmen.



© Bledi Hoxha / PPNEA

Parku Kombëtar & Shërbimet e tij

Një Park Kombëtar është një hapësirë natyrore ose gjysmë-natyrore që një shtet sovran e shpall e përdor dhe e mbron nëpërmjet një sërë ligjesh të veçanta. Në përgjithësi qëllimi i shpalljes së parqeve kombëtare është të ruajë vlerat natyrore për brezat pasardhës si simbol i krenarisë kombëtare.

Shumë prej parqeve kombëtare ofrojnë mundësi më të mira për ruajtjen e vlerave natyrore, por edhe për përdorimin në terma afatgjatë të burimeve. Nga ana tjetër një Park Kombëtar lumor si ky që ne propozojmë, ka një rëndësi shkencore të pakrahasueshme. Për këto arsye është e domosdoshme shpallja e këtij Parku Kombëtar nga institucionet përkatëse në përputhje me kriteret e posaçme të përcaktuara nga organizmat ndërkombëtare.

Një Park Kombëtar nuk duhet konsideruar si një zonë e rrethuar me tela me gjëmba, përkundrazi mbrojtja duhet konceptuar si një mënyrë për të vendosur një harmoni afatgjatë midis njeriut dhe natyrës. Kësisoj, një Park Kombëtar mund të ofrojë në mënyrë më afatgjatë shërbimet e një ekosistemi. Shërbime të tilla si rekreacioni, bujqësia jo intensive apo sportet lumore mund të jenë një alternativë efikase në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunitetit lokal.

Vjosa Parku Kombëtar Të mbrojmë të ardhmen



© Arno Mohl/WWF AT

Së bashku me komunitetin lokal, specialistët dhe të tjerë grupe të interesit le të nisim hartimin e një koncepti për të shpallur Vjosën, Park Kombëtar sepse ajo përfaqëson një trashëgimi të vyer natyrore jo vetëm për Shqipërinë por për gjithë Evropën.

Për këtë arsye le t'i kërkojmë Qeverisë shqiptare të heqë dorë nga planet e përfitimit të çastit, ashtu siç kemi duke bërë përmes ndërtimit të Hidrocentraleve dhe të shohim me largpamësi të ardhmen duke i dhënë Vjosës statusin që ky ekosistem unik meriton.

Atë që natyra na ofron sot nuk e kemi trashëgim nga paraardhësit tanë, por ua kemi marrë hua fëmijëve tanë!

